



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR LICENCIM DHE GARIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

EDICIONI 2025/26



PËRMBAJTJA:

RREGULLORE PËR LICENCIM DHE GARIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS, EDICIONI 2025/26

Neni 1 – Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores	3
Neni 2 – Programi i Licencimit në FBK	4
Neni 3 – Objektivat e Procesit të Licencimit	4
Neni 4 – Kriteret e Përgjithshme dhe Kategorizimi i Licencave	4
Neni 5 – Përgatitja për Procesin e Licencimit	6
Neni 6 – Kriteret sipas Licencës Përkatëse	6
6.1. LICENCA A.....	6
6.2. LICENCA B.....	11
6.3. LICENCA C.....	14
6.4. LICENCA D	17
Neni 7 – Komisioni për Licencim dhe Aplikimi për Licencë	20
Neni 8 – Koordinimi me organet shtetërore	21
Neni 9 – Pezullimi dhe Revokimi i Licencës	22
Neni 10 – Papajtueshmëria sipas Ligjit për Sport.....	23
Neni 11 – Sanksionet sipas Ligjit për Sport.....	24
Neni 12 – Vlerësimi i Kriteve për Licencim	24
Neni 13 – Dispozita përfundimtare	24
<u>ANEKS I: RREGULLORE PËR SHPENZIMET E DEDIKUARA PËR ZHVILLIMIN E GJENERATAVE TË REJA NGA KLUBET E SUPERLIGËS MESHKUJT</u>	25
<u>ANEKS II: DOKUMENT UDHËZUES – PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN DHE TRAJNIMIN E GJENERATAVE TË REJA</u>	28
<u>ANEKS III: RREGULLORE PËR MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E SHKOLLAVE TË BASKETBOLLIT</u>	36



Në bazë të Nenit 24, alineja 1.3. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 03.08.2025, miraton këtë:

RREGULLORE PËR LICENCIM DHE GARIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS EDICIONI 2025/26

Neni 1 - Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores

- 1.** Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), si organi i vetëm përgjegjës për organizimin e garave të basketbollit në të gjitha disiplinat e këtij sporti në territorin e Republikës së Kosovës, e harton këtë Rregullore nëpërmjet të cilës saktësohen kriteret dhe procedura për licencim pranë Federatës së Basketbollit të Kosovës, të klubeve të basketbollit, shkollave të basketbollit dhe subjekteve tjera në territorin e Kosovës që merren në mënyrë të organizuar me basketboll, si parakusht për pjesëmarrje në garat e organizuara nga FBK.
- 2.** Licencimi i klubeve është i përfshirë në Statutin e FBK-së, andaj subjektet janë të obliguara ligjërisht të respektojnë kërkesat e programit të licencimit në mënyrë që të marrin pjesë në garat e basketbollit.
- 3.** Termat e përdorur në gjininë mashkullore (p.sh. "lojtarë", "trajnerë", "anëtarë") kanë kuptim neutral gjinor dhe përfshijnë në mënyrë të barabartë të gjitha gjinitë. Ky standard zbatohet për të gjithë tekstin e Rregullores dhe pjesët përbërëse të saj.
- 4.** Kriteret për licencim luajnë rol tejet të rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë, integritetit, sigurisë dhe stabilitetit financiar të garave.
- 5.** Në edicionin 2025/26 kriteret për licencim do të aplikohen për:
 - 1.1.** Klubet e Superligës Meshkujt;
 - 1.2.** Klubet e Superligës Femrat;
 - 1.3.** Klubet e Ligës së Parë Meshkujt;
 - 1.4.** Klubet e Ligës Zhvillimore për Vajzat U21.



1.5. Shkollat e basketbollit (të cilat nuk funksionojnë në kuadër të klubeve sportive).

Neni 2 - Programi i Licencimit në FBK

- 1.** Licencimi i një klubi/shkolle dokumentohet me vendim të Bordit të FBK-së para fillimit të edicionit të ri. Për tu pajisur me licencë: klubet, shkollat e basketbollit dhe subjektet tjera në territorin e Kosovës që merren në mënyrë të organizuar me basketboll duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.
- 2.** Licenca është e vlefshme për një edicion garues në basketboll dhe rinovohet para fillimit të edicionit në garën ose veprimtarinë ku bën pjesë subjekti që e posedon licencën.
- 3.** Pa posedim të licencës, asnjë subjekt nuk mund ta ushtrojë të drejtën e pjesëmarrjes në ndonjë garë ose organizimit të ndonjë gare të basketbollit.

Neni 3 - Objektivat e Procesit të Licencimit

- 1.** Federata e Basketbollit të Kosovës nëpërmjet kriterëve të përcaktuara për licencim të klubeve mëton që:
 - 1.1.** Të profesionalizojë klubet dhe shkollat e basketbollit;
 - 1.2.** Të ngritë standardet e klubeve, shkollave dhe vetë Federatës;
 - 1.3.** Të përforcojë besueshmërinë dhe integritetin e garave;
 - 1.4.** Të stimulojë zhvillimin e gjeneratave të reja;
 - 1.5.** Të përmirësojë standardet e menaxhimit dhe të sigurojë qëndrueshmëri financiare;
 - 1.6.** Të sigurojë kushtet bazë për ushtrimin e veprimtarisë së basketbollit (përfshirë posedimin e infrastrukturës optimale);
 - 1.7.** Të ketë paraqitje sa më të mirë dhe transparente para publikut.

Neni 4 - Kriteret e Përgjithshme dhe Kategorizimi i Licencave

- 1.** Kriteret e përgjithshme për licencimin e klubeve dhe shkollave në FBK janë të ndara në 5 shtylla bazë, ndërkaq specifikat sipas kategorisë së licencës janë të specifikuara në nenin 6 të kësaj Rregullore:



1.1. Kriteri Sportiv: Klubet duhet të regjistrojnë lojtarët në FBK, të respektojnë rregulloret garuese dhe të kenë ekiye të kategorive të reja sipas nivelit të licencimit.

1.2. Kriteri Financiar: Klubet duhet të dorëzojnë raport financiar, raport të auditimit dhe plan financiar vjetor, duke siguruar stabilitetin financiar.

1.3. Kriteri Ligjor, Etik dhe Disiplinor: Klubet duhet të jenë të regjistruara, të kenë akte normative të miratuara, të zbatojnë rregullat disiplinore dhe kodin e qeverisjes së mirë.

1.4. Kriteri Administrativ dhe i Personelit: Klubet duhet të kenë struktura organizative të rregulluara, staf administrativ dhe zyrtar financiar.

1.5. Kriteri Infrastrukturor: Klubet duhet të kenë ambiente adekuate për garim dhe stërvitje, sipas rregullave të FBK dhe FIBA.

2. Si para-kusht për pjesëmarrje në gara, Federata e Basketbollit të Kosovës në edicionin 2025/26 përcakton kriteret sipas kategorizimit në vijim:

2.1. Licenca A – për klubet e Superligës Meshkujt dhe Superligës Femrat;

2.2. Licenca B – për klubet e Ligës së Parë Meshkujt;

2.3. Licenca C – për klubet e Ligës Ligës Zhvillimore për Vajzat U21;

2.4. Licenca D – për shkollat e basketbollit (të cilat nuk funksionojnë në kuadër të klubeve sportive).

3. Kategorizimi i licencave ka për qëllim diferencimin e subjekteve në bazë të nivelit garues (profesional, gjysmë-profesional apo amator), në mënyrë që kriteret të përkojnë me rrethanat, kapacitetin dhe standardin e pritur për atë nivel.

4. Është e rëndësishë që të gjitha klubet dhe shkollat të zbatojnë kriteret për licencim me përpikëri, në mënyrë që të jenë shembull, jo vetëm për klubet e kategorive më të ulëta në basketboll, por për të gjitha sportet kolektive në Kosovë.



Neni 5 - Përgatitja për Procesin e Licencimit

1. FBK do të përgatitë formularët e aplikimit dhe dokumentet apo shabllonet e tjera të nevojshme dhe do të caktoj afatet përkatëse për klubet dhe shkollat që të paraqesin dokumentacionin e tyre. Të gjitha këto, përfshirë mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve, do të përcillen dhe komunikohen tek klubet dhe shkollat para hapjes së procesit të licencimit.
2. Afati për dorëzimin e aplikacioneve për licencim nga klubet dhe shkollat e basketbollit është jo më vonë se 30 ditë para fillimit të edicionit të ri garues (p.sh. nga 4 gusht deri më 4 shtator 2025).
3. Vendimi për licencim nga Bordi i FBK-së publikohet brenda 7 ditëve nga miratimi dhe i komunikohet klubeve përmes emailit zyrtar dhe publikimit në faqen zyrtare të FBK-së.

Neni 6 - Kriteret sipas Licencës Përkatëse

Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore dhe ligjit për sport në fuqi në Republikën e Kosovës, FBK saktëson kriteret për secilën licencë.

6.1. LICENCA A

Licenca A lëshohet për klubet e Superligës Meshkujt dhe Superligës Femrat, si nivelet më të larta garuese në sportin e basketbollit në Kosovë (profesional).

(a) **KRITERI SPORTIV**

- **Regjistrimi i lojtarëve në FBK;**
- **Kontrolli shëndetësor:**
 - Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
 - Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të kryhet dy herë përgjatë edicionit garues. Kontrolli shëndetësor duhet të vërtetojë se sportisti është i aftë për garë duke u bazuar në statusin shëndetësor të sportistit, grup-moshën



dhe nivelin garues (këto ekzaminime shpesh përfshijnë teste kardiovaskulare, vlerësime ortopedike dhe ekzaminime të përgjithshme shëndetësore).

- Kontrolli shëndetësor bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. FBK njeh edhe kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.

- **Ekipet e gjeneratave të reja:**

- Për klubet e Superligës Meshkujt - U10, U12, U14, U16, U18.
- Për klubet e Superligës femrat - U12, U14, U16.

- **Programi për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja**

- Klubet obligohen të dorëzojnë Programin për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja sipas udhëzimeve të bashkëngjitura kësaj Rregullore në formë të [ANEKS II: Dokument Udhëzues - Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja](#).

- **Programet apo politikat me karakter edukativ apo social** (qoftë organizimi i programeve edukative, komunikimi konstruktiv dhe bashkëpunimi me tifozët, mbrojtja e të rinjve, etj.)

(b) KRITERI FINANCIAR

Klubet duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë:

- **Raporti financiar dhe raporti i auditimit** (të cilat duhet publikuar edhe në faqet zyrtare);
- **Planin financiar** (duke reflektuar se do të posedojnë burime të mjaftueshme për të operuar gjatë edicionit vijues);
 - Për edicionin 2025/26, çdo klub i Superligës Meshkujt obligohet të ndajë minimum 10% të buxhetit të tij vjetor të planifikuar për zhvillimin e gjeneratave të reja, përkatësisht për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e ekipeve zinxhirore të klubit (U10-U18). Për zbatimin e këtij kushti, FBK ka miratuar [ANEKS I: Rregullore për Shpenzimet e Dedikuara për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja nga Klubet e Superligës Meshkujt](#).
- **Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA.**



(c) KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

Klubet duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, nuk kanë obligime ndaj organeve tatimore, zbatojnë obligimet ndaj sportistëve dhe se respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme, politikat kundër dopingut dhe kundër dhunës apo dukurive tjera negative në sport:

- **Regjistrimi si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare**, në përputhje me ligjet përkatëse;
- **Aktet normative të klubit** të miratuara nga organi kompetent (Statuti dhe Rregullorja Disiplinore);
- Klubi sportiv mban **së paku një herë në vit mbledhjen e Kuvendit** në të cilin shqyrtohet raporti financiar dhe plani i punës për vitin aktual;
- **Obligimet ndaj organeve tatimore;**
- **Kontratat me sportistët profesional:**
 - Lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në FBK;
 - Lidhet në kohëzgjatje të caktuar prej më së shumti 5 vite dhe nuk parasheh periudhë provuese;
 - Përcakton pagën që e pranon sportisti (e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës) dhe shpërblimet eventuale për arritjen e rezultateve të larta sportive ose të ardhura tjera të përcaktuara me kontratë (të cilat konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti).
 - Përcakton autoritetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kontratës.
- **Zbatimi i Politikave të Mbrojtjes të miratuara nga FBK**
 - Çdo klub i licencuar obligohet të njohë dhe zbatojë Politikën e Mbrojtjes të miratuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës, duke emëruar një person përgjegjës për zbatimin e tyre dhe duke siguruar që stafi dhe trajnerët të jenë të informuar dhe të trajnuar mbi mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e lojtarëve, veçanërisht të miturve.



(d) KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

Klubet duhet të kenë personel të kualifikuar dhe ambient të përshtatshëm për punë. Asnjë person me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale, përveç atyre nga pakujdesia, apo i pezulluar nga Gjykata sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të kryejë punë profesionale në sport, nuk mund të jetë pjesë e organeve drejtuese të organizatave sportive dhe klubeve sportive.

- **Zyre** me hapësirë për takime, internet, email zyrtar, strukturë të rregullt dhe të lajmëruar në MAP;
- **Organogrami i klubit apo lista e të punësuarve në klub:**
 - Së paku të ketë: Drejtorin e Përgjithshëm / Menaxherin Ekzekutiv (përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të klubit), Drejtorin Sportiv (menaxhon aspektet sportive të klubit), Zyrtarin Financiar, Trajnerin Kryesor, Ndhmës-trajnerë, Mjekun Sportiv dhe Fizioterapeutin.
 - Rekomandohen: Përgjegjës për Media dhe Komunikim, Zyrtar për Siguri, Koordinator për Gjeneratat e Reja.
- **Organet qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)** - Në përputhje me Ligjin për Sport në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë të merret parasysh se:
 - strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit;
 - një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të sportit të njëjtë;
 - në fushën e menaxhimit apo si aksionar i klubit sportiv nuk mund të jetë personi i cili ushtron veprimtari të basteve sportive apo që e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje ligjin;
 - personat që janë pjesë e organizatave të sportit në çfarëdo forme, nuk mund të marrin pjesë në procedurat administrative të



vendimmarrjes për financim të sportit në kuadër të mekanizmave institucionale;

- një person fizik mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv vetëm në një klub sportiv të sportit të njëjtë;
- një person nuk mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv nëse është: i dënuar për vepër penale; sportist profesional; agjent sportiv; ose anëtar i personit juridik që merret me aktivitete të organizimit sportiv.

- **Ngritja e kapaciteteve njerëzore** – ndjekja e kurseve/seminareve nga FBK/KOK/FIBA në rast të organizimit.

(e) KRITERI INFRASTRUKTUROR

Klubet duhet të dëshmojnë se posedojnë infrastrukturën optimale për ushtrimin e veprimtarisë së klubit, që duhet të vërtetohet nga Komesari i Garave konform Propozicioneve të Garave të FBK-së:

- **Kushtet për ndeshje, stërvitje dhe organizim** të ngjarjeve/eventeve konform Propozicioneve të Garave dhe Rregullave Zyrtare të FIBA-s (për të gjitha kategoritë);
- **Marrëveshja me Policinë e Kosovës dhe sigurimin privat** për sigurinë gjatë ndeshjeve/ngjarjeve.

2. Ndërkaq, kriteret në vijim inkurajohen nga FBK, me qëllim që gradualisht, me ngritjen e profesionalizmit, të inkuadrohen në shtyllat bazë:

(a) Qeverisja e mirë

- Strategjia e klubit dhe planifikimi operacional;
- Politikat dhe procedurat financiare;
- Organizimi i brendshëm (punësimi dhe vlerësimi i stafit);
- Publikimi i akteve normative, raporteve dhe vendimeve në faqen zyrtare të klubit.

(b) Brendi, komunikimi dhe marketingu

- Plani i marketingut;
- Faqe zyrtare e klubit;



- Plani i komunikimit.

6.2. LICENCA B

Licenca B lëshohet për klubet e Ligës së Parë Meshkujt, si nivel gjysmë-profesional në sportin e basketbollit në Kosovë.

(a) KRITERI SPORTIV

- **Regjistrimi i lojtarëve në FBK;**
- **Kontrolli shëndetësor:**
 - Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
 - Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të kryhet dy herë përgjatë edicionit garues. Kontrolli shëndetësor duhet vërtetohet se sportisti është i aftë për garë (këto ekzaminime shpesh përfshijnë teste kardiovaskulare, vlerësime ortopedike dhe ekzaminime të përgjithshme shëndetësore).
 - Kontrolli shëndetësor bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. FBK njeh edhe kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.
- **Ekipet e gjeneratave të reja** – minimum 2 ekipe prej kategorive të reja (prej minibasketbollit, U14, U16 dhe U18);
- **Programi për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja**
 - Klubet obligohen të dorëzojnë Programin për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja sipas udhëzimeve të bashkëngjitura kësaj Rregullore në formë të [ANEKS II: Dokument Udhëzues - Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja](#).

(B) KRITERI FINANCIAR

Klubet duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë:

- **Raporti financiar dhe raporti i auditimit;**



- **Planin financiar** (duke reflektuar se do posedojnë burime të mjaftueshme për të operuar gjatë edicionit vijues);
- **Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA.**

(c) KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

Klubet duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, nuk kanë obligime ndaj organeve tatimore, zbatojnë obligimet ndaj sportistëve dhe se respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme, politikat kundër dopingut dhe kundër dhunës apo dukurive tjera negative në sport:

- **Regjistrimi si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare**, në përputhje me ligjet përkatëse;
- **Aktet normative të klubit** të miratuara nga organi kompetent (Statuti dhe Rregullorja Disiplinore);
- Klubi sportiv mban **së paku një herë në vit mbledhjen e Kuvendit** në të cilin shqyrtohet raporti financiar dhe plani i punës për vitin aktual;
- **Obligimet ndaj organeve tatimore;**
- **Kontratat me sportistët profesional:**
 - Lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në FBK;
 - Lidhet në kohëzgjatje të caktuar prej më së shumti 5 vite dhe nuk parasheh periudhë provuese;
 - Përcakton pagën që e pranon sportisti (e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës) dhe shpërblimet eventuale për arritjen e rezultateve të larta sportive ose të ardhura tjera të përcaktuara me kontratë (të cilat konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti).
 - Përcakton autoritetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kontratës.
- **Zbatimi i Politikave të Mbrojtjes të miratuara nga FBK**
 - Çdo klub i licencuar obligohet të njohë dhe zbatojë Politikën e Mbrojtjes të miratuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës, duke emëruar një person përgjegjës për zbatimin e tyre dhe duke siguruar që stafi dhe trajnerët të jenë të informuar dhe të



trajnuar mbi mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e lojtarëve, veçanërisht të miturve.

(d) KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

Klubet duhet të kenë personel të kualifikuar dhe ambient të përshtatshëm për punë:

- **Zyre** me hapësirë për takime, internet, email zyrtar, strukturë të rregullt dhe të lajmëruar në MAP;
- **Organogrami i klubit apo lista e të punësuarve në klub:**
 - Së paku të ketë: një person të punësuar në administratë dhe një zyrtar financiar.
- **Organet qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)** - Në përputhje me Ligjin për Sport në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë të merret parasysh se:
 - strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit;
 - një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të sportit të njëjtë;
 - në fushën e menaxhimit apo si aksionar i klubit sportiv nuk mund të jetë personi i cili ushtron veprimtari të basteve sportive apo që e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje ligjin;
 - personat që janë pjesë e organizatave të sportit në çfarëdo forme, nuk mund të marrin pjesë në procedurat administrative të vendimmarrjes për financim të sportit në kuadër të mekanizmave institucionale;
 - një person fizik mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv vetëm në një klub sportiv të sportit të njëjtë;
 - një person nuk mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë



pozitën e drejtorit ekzekutiv nëse është: i dënua për veprë penale; sportist profesional; agjent sportiv; ose anëtar i personit juridik që merret me aktivitete të organizimit sportiv.

(e) KRITERI INFRASTRUKTUROR

Klubet duhet të dëshmojnë se posedojnë infrastrukturën optimale për ushtrimin e veprimtarisë së klubit, që duhet vërtetohet nga Komesari i Garave konform Propozicioneve të Garave të FBK-së:

- **Kushtet për ndeshje, stërvitje dhe organizim** të ngjarjeve/eventeve konform Propozicioneve të Garave dhe Rregullave Zyrtare të FIBA-s (për të gjitha kategoritë);
- **Marrëveshja me Policinë e Kosovës dhe sigurimin privat** për sigurinë gjatë ndeshjeve/ngjarjeve.

6.3. LICENCA C

Licenca C lëshohet për klubet e Ligës Zhvillimore për Vajzat U21, si nivel amator në sportin e basketbollit në Kosovë.

(a) KRITERI SPORTIV

- **Regjistrimi i lojtarëve në FBK;**
- **Kontrolli shëndetësor:**
 - Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
 - Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të kryhet para fillimit të edicionit garues. Kontrolli shëndetësor duhet vërtetohet se sportisti është i aftë për garë (këto ekzaminime shpesh përfshijnë teste kardiovaskulare, vlerësime ortopedike dhe ekzaminime të përgjithshme shëndetësore).
 - Kontrolli shëndetësor bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. FBK njeh edhe kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.



- **Ekipet e gjeneratave të reja** - minimum 1 ekip prej kategorive të reja (prej minibasketbollit, U14, U16 dhe U18).
- **Programi për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja**
 - Klubet obligohen të dorëzojnë Programin për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja sipas udhëzimeve të bashkëngjitura kësaj Rregullore në formë të [ANEKS II: Dokument Udhëzues - Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja](#).

(b) KRITERI FINANCIAR

Klubet duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë:

- **Raporti financiar dhe raporti i auditimit;**
- **Planin financiar** (duke reflektuar se do posedojnë burime të mjaftueshme për të operuar gjatë edicionit vijues);
- **Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA.**

(c) KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

Klubet duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, nuk kanë obligime ndaj organeve tatimore, zbatojnë obligimet ndaj sportistëve dhe se respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme, politikat kundër dopingut dhe kundër dhunës apo dukurive tjera negative në sport:

- **Regjistrimi si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare**, në përputhje me ligjet përkatëse;
- **Aktet normative të klubit** të miratuara nga organi kompetent (Statuti dhe Rregullorja Disiplinore);
- Klubi sportiv mban **së paku një herë në vit mbledhjen e Kuvendit** në të cilin shqyrtohet raporti financiar dhe plani i punës për vitin aktual;
- **Obligimet ndaj organeve tatimore;**
- **Kontratat me sportistët profesional (në rast se ka të tillë):**
 - Lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në FBK;
 - Lidhet në kohëzgjatje të caktuar prej më së shumti 5 vite dhe nuk parasheh periudhë provuese;
 - Përcakton pagën që e pranon sportisti (e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në



Republikën e Kosovës) dhe shpërblimet eventuale për arritjen e rezultateve të larta sportive ose të ardhura tjera të përcaktuara me kontratë (të cilat konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti).

- Përcakton autoritetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kontratës.

- **Zbatimi i Politikave të Mbrojtjes të miratuara nga FBK**

- Çdo klub i licencuar obligohet të njohë dhe zbatojë Politikën e Mbrojtjes të miratuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës, duke emëruar një person përgjegjës për zbatimin e tyre dhe duke siguruar që stafi dhe trajnerët të jenë të informuar dhe të trajnuar mbi mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e lojtarëve, veçanërisht të miturve.

(d) KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

Klubet duhet të kenë personel të kualifikuar dhe ambient të përshtatshëm për punë:

- **Zyre** me hapësirë për takime, internet, email zyrtar, strukturë të rregullt dhe të lajmëruar në MAP;
- **Organogrami i klubit apo lista e të punësuarve në klub:**
 - Së paku të ketë: një person të punësuar në administratë dhe një zyrtar financiar.
- **Organet qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)** - Në përputhje me Ligjin për Sport në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë të merret parasysh se:
 - strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit;
 - një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të sportit të njëjtë;



- në fushën e menaxhimit apo si aksionar i klubit sportiv nuk mund të jetë personi i cili ushtron veprimtari të basteve sportive apo që e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje ligjin;
- personat që janë pjesë e organizatave të sportit në çfarëdo forme, nuk mund të marrin pjesë në procedurat administrative të vendimmarrjes për financim të sportit në kuadër të mekanizmave institucionale;
- një person fizik mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv vetëm në një klub sportiv të sportit të njëjtë;
- një person nuk mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv nëse është: i dënuar për vepër penale; sportist profesional; agjent sportiv; ose anëtar i personit juridik që merret me aktivitete të organizimit sportiv.

(e) KRITERI INFRASTRUKTUROR

Klubet duhet të dëshmojnë se posedojnë infrastrukturën optimale për ushtrimin e veprimtarisë së klubit, që duhet vërtetohet Komesari i Garave konform Propozicioneve të Garave të FBK-së:

- **Kushtet për ndeshje, stërvitje dhe organizim** të ngjarjeve/eventeve konform Propozicioneve të Garave dhe Rregullave Zyrtare të FIBA-s (për të gjitha kategoritë).

6.4. LICENCA D

Licenca D lëshohet për shkollat e basketbollit, të cilat nuk funksionojnë në kuadër të klubeve të basketbollit. Shkolla e basketbollit është person juridik që zhvillon veprimtarinë sportive të trajnimit ose dhënies së instruksioneve sportive për sportistët nën moshën 18 vjeçare.

(a) KRITERI SPORTIV

- **Regjistrimi i lojtarëve në FBK;**
- **Kontrolli shëndetësor:**



- Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
- Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të kryhet para fillimit të edicionit garues. Kontrolli shëndetësor duhet vërtetohet se sportisti është i aftë për garë (këto ekzaminime shpesh përfshijnë teste kardiovaskulare, vlerësime ortopedike dhe ekzaminime të përgjithshme shëndetësore).
- Kontrolli shëndetësor bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. FBK njeh edhe kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.
- **Ekipet e gjeneratave të reja** – minimum 2 ekipe prej kategorive të reja (prej minibasketbollit, U14, U16 dhe U18);
- **Programi për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja**
 - Shkollat obligohen të dorëzojnë Programin për zhvillimin dhe trajnimin e gjeneratave të reja sipas udhëzimeve të bashkëngjitura kësaj Rregullore në formë të [ANEKS II: Dokument Udhëzues – Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja](#).

(b) KRITERI FINANCIAR

Shkollat duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë:

- **Raporti financiar dhe raporti i auditimit;**
- **Planin financiar** (duke reflektuar se do posedojnë burime të mjaftueshme për të operuar gjatë edicionit vijues);
- **Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA.**

(c) KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

Shkollat duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, nuk kanë obligime ndaj organeve tatimore dhe se respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme dhe politikat kundër dhunës apo dukurive tjera negative në sport:

- **Regjistrimi si shoqëri tregtare**, në përputhje me ligjet përkatëse;
- **Aktet normative** të shkollës të miratuara nga organi kompetent (Statuti dhe Rregullorja Disiplinore);



- **Obligimet ndaj organeve tatimore;**
- **Zbatimi i Politikave të Mbrojtjes të miratuara nga FBK**
 - Çdo klub i licencuar obligohet të njohë dhe zbatojë Politikën e Mbrojtjes të miratuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës, duke emëruar një person përgjegjës për zbatimin e tyre dhe duke siguruar që stafi dhe trajnerët të jenë të informuar dhe të trajnuar mbi mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e lojtarëve, veçanërisht të miturve.

(d) KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

Shkollat duhet të kenë personel të kualifikuar dhe ambient të përshtatshëm për punë:

- **Zyre** me hapësirë për takime, internet, email zyrtar, strukturë të rregullt dhe të lajmëruar në MAP;
- **Organogrami i klubit apo lista e të punësuarve në klub:**
 - Së paku një trajner dhe një ndihmës-trajner (nëse ka mbi 15 fëmijë);
 - Së paku të ketë: një koordinator të gjeneratave të reja, një person të punësuar në administratë dhe një zyrtar financiar.
- **Organet qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)** - Në përputhje me Ligjin për Sport në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë të merret parasysh se:
 - strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit;
 - një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të sportit të njëjtë;
 - në fushën e menaxhimit apo si aksionar i klubit sportiv nuk mund të jetë personi i cili ushtron veprimtari të basteve sportive apo që e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje ligjin;



- o personat që janë pjesë e organizatave të sportit në çfarëdo forme, nuk mund të marrin pjesë në procedurat administrative të vendimmarrjes për financim të sportit në kuadër të mekanizmave institucionale;
- o një person fizik mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv vetëm në një klub sportiv të sportit të njëjtë;
- o një person nuk mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv nëse është: i dënuar për vepër penale; sportist profesional; agjent sportiv; ose anëtar i personit juridik që merret me aktivitete të organizimit sportiv.

(e) KRITERI INFRASTRUKTUROR

Shkollat duhet të dëshmojnë se posedojnë infrastrukturën optimale për ushtrimin e veprimtarisë së klubit, që duhet vërtetohet nga Komesari i Garave konform Propozicioneve të Garave të FBK-së:

- **Kushtet për ndeshje, stërvitje dhe organizim** të ngjarjeve/eventeve konform Propozicioneve të Garave dhe Rregullave Zyrtare të FIBA-s (për të gjitha kategoritë).
 - o Preferohet të sigurohen koshat me lartësi adekuate për grupe të mini-basketbollit
- **Kontrata me sallat/palestrat që shfrytëzohen për stërvitje dhe ndeshje/termine.**

Neni 7 - Komisioni për Licencim dhe Aplikimi për Licencë

1. Komisioni për Licencim i FBK-së është kompetent për shqyrtimin e aplikacioneve të pranura nga klubet dhe shkollat e basketbollit.

2. Komisioni për Licencim ka detyrat si më poshtë:

2.1. Para çdo fillim edicioni të shqyrtojë aplikacionet për licencim të klubeve dhe shkollave të basketbollit;



2.2. Si pjesë e shqyrtimit të aplikacioneve, të jep komente për plotësim të aplikacioneve nga klubet apo shkollat;

2.3. Të rekomandojë për aprovim listën e klubeve dhe shkollave që përmbushin kriteret përkatëse për licencim (lista preliminare).

3. Pas përpilimit të rekomandimit/listës preliminare, klubet apo shkollat e pa-kënaqura mund të paraqesin ankesë drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së dhe atë në afat prej 72 orëve nga pranimi i listës përmes postës elektronike.

4. Pas listës preliminare apo pas trajtimit të ankesave nga Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit, përpilohet rekomandimi final drejtuar Bordit të FBK-së. Pas pranimi të rekomandimit, Bordi i FBK-së nxjerr vendimin me klubet dhe shkollat e licencuara për edicionin garues.

5. Federata mund të ofrojë licencim me kusht për klubet që nuk përmbushin të gjitha kriteret e licencimit brenda afateve, duke u dhënë një afat të caktuar për plotësimin e kushteve të mbetura në përputhje me këtë Rregullore.

6. Klubet dhe shkollat e pa-licencuara nuk mund të marrin pjesë në garat për edicionin vijues. Për më shumë, klubet apo shkollat e licencuara me kusht, të cilat nuk plotësojnë kriteret brenda afatit të përcaktuar, largohen nga garat përkatëse.

Neni 8 - Koordinimi me organet shtetërore

1. Federata e Basketbollit të Kosovës në fillim të çdo edicioni do të informoj organet përkatëse shtetërore (Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport) me listën e emrave të ekipeve të licencuara për edicionin vijues garues.

2. Organizimi dhe ushtrimi i aktiviteteve të basketbollit nga subjektet që nuk kanë licencë të FBK-së përbën shkelje të akteve normative të FBK-së dhe cilësohet si pengim i FBK-së në ushtrimin e veprimtarisë së vet.

3. FBK në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës, komunat përkatëse dhe organet tjera e merr përsipër që ti mbrojë të drejtat e subjekteve të licencuara dhe të reagojë menjëherë në rast se veprimtaria e tyre pengohet nga subjekte të pa-licencuara.



4. Federata e Basketbollit të Kosovës është garantuese e vlefshmërisë të licencës para organeve të veta dhe organeve shtetërore dhe obligohet që licencat ti lëshojë në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 9 - pezullimi dhe Revokimi i Licencës

1. Federata e Basketbollit të Kosovës e ruan të drejtën që të pezullojë ose revokojë licencën/at e lëshuar/a në rast se konstatohen shkelje të kësaj Rregulloreje apo të Ligjit për Sport në fuqi në Republikën e Kosovës nga bartësi i licencës.

2. Federata e Basketbollit të Kosovës FBK rezervon të drejtën që gjatë edicionit garues të realizojë inspektime të papritura dhe/ose të planifikuara në klubet e licencuara, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së vazhdueshme të kriterëve të licencimit. Klubet obligohen të ofrojnë bashkëpunim dhe qasje të plotë në dokumentacion dhe veprimtari të ndërlidhura me licencimin.

3. Pezullimi i licencës bëhet kur:

3.1. licenca është siguruar në bazë të dokumenteve të falsifikuara apo informacionit tjetër jo të vërtetë;

3.2. themeluesit dhe përfaqësuesit e strukturave qeverisëse ushtrojnë veprimtari për qëllime tjera nga ato që janë përcaktuar në aktin e themelimit;

3.3. shkelen dispozitat e përcaktuara me Ligjin për Sport në fuqi në Republikën e Kosovës;

3.4. kriteret e përgjithshme sipas kësaj Rregullore nuk mund të konsiderohen më si të përmbushura.

4. Pezullimi ka karakter të përkohshëm, ku klubit apo shkollës i ofrohet mundësia për të përmirësuar shkeljen e konstatuar nga paragrafi 3 i këtij neni, në afatin e përcaktuar nga FBK.

5. Në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve apo mos-bashkëpunimit, Bordi i FBK-së, pas rekomandimit të Komisionit për Licencim, revokon licencën e klubit apo shkollës.



6. Duke marr parasysh ndjeshmërinë e aktivitetit të shkollave të basketbollit, korniza për monitorimin dhe vlerësimin e tyre rregullohet tutje përmes Rregullores për Monitorimin dhe Vlerësimin e Shkollave të Basketbollit në Republikën e Kosovës, bashkëngjitur kësaj Rregullore në formë të [ANEKS III](#).

7. Kundër vendimit për revokim të licencës nga paragrafi 5 i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së dhe atë brenda 72 orëve nga pranimi i vendimit për revokim përmes postës elektronike.

Neni 10 - Papajtueshmëria sipas Ligjit për Sport

1. Asnjë person me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale, përveç atyre nga pakujdesia, apo i pezulluar nga Gjykata sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të kryejë punë profesionale në sport, nuk mund të jetë pjesë e organeve drejtuese të klubeve apo shkollave sportive. I njëjti person nuk do të ketë qasje në ambientet e organizatës, nuk do të ketë të drejtë të ndërmarrë detyrë zyrtare dhe do të përmbahet nga kontakti me punonjësit në zyrën/ambientin sportiv. Ky rregull aplikohet edhe në rastet e kandidimit apo përzgjedhjes në funksionet e lartpërmendura.

2. Klubi apo shkolla, brenda afatit prej tre (3) ditë pasi të ketë rënë në dijeni për dënimin e formës së prerë sipas Ligjit për Sport në fuqi, është i detyruar ta përjashtojë personin nga përfshirja e mëtutjeshme në veprimtari sportive, duke bërë çregjistrimin, shkëputur kontratën apo ndërmarrë çdo veprim tjetër për ndërprerjen e aktivitetit.

3. Nëse klubi apo shkolla kupton që ndaj një personi pjesëmarrës në veprimtari sportive është iniciuar rasti për vepër penale ndaj fëmijës, menjëherë do ta pezullojë atë nga çfarëdo veprimtarie që mund ta sjellë në kontakt me fëmijët, deri në vendimin e plotfuqishëm të gjykatës.



Neni 11 - Sanksionet sipas Ligjit për Sport

Përveç masave të parashikuara në këtë Rregullore, të gjithë subjektet që marrin pjesë në veprimtarinë e basketbollit kuptojnë se i nënshtrohen gjithashtu sanksioneve të përcaktuara në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sport në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 12 - Vlerësimi i Kritereve për Licencim

1. FBK ka të drejtë që pas çdo edicioni të bëjë vlerësimin kriterëve për licencim dhe garim, si dhe të kësaj Rregulloreje në tërësi dhe të përditësojë ato me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të anëtarëve të saj, por edhe gjithë basketbollit në vendin tonë. Në kuadër të vlerësimit vjetor të kriterëve për licencim dhe të kësaj Rregulloreje, FBK do të organizojë proces konsultativ me përfaqësues të klubeve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të zbatueshme dhe përshtatjen e tyre me zhvillimet bashkëkohore në basketbollin vendor dhe ndërkombëtar.

Neni 13 - Dispozita përfundimtare

Kjo Rregullore është e harmonizuar me Statutin dhe aktet tjera normative të FBK-së dhe Ligjin për Sport në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit.

E miratuar në Prishtinë më 03.08.2025.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar

Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit të Kosovës



ANEKS I

RREGULLORE PËR SHPENZIMET E DEDIKUARA PËR ZHVILLIMIN E GJENERATAVE TË REJA NGA KLUBET E SUPERLIGËS MESHKUJT

Neni 1 - Qëllimi i Rregullores

1. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e Rregullores për Licencim dhe Garim dhe e Federatës së Basketbollit të Kosovës (edicioni 2025/26) dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e saj.
2. Kjo Rregullore ka për qëllim të mbështesë zbatimin e kriterit financiar për Licencën A, pra të përcaktojë detyrimin financiar të klubeve të Superligës Meshkujt për të ndarë një pjesë të buxhetit të tyre vjetor për zhvillimin e gjeneratave të reja, duke specifikuar mënyrën e raportimit dhe monitorimit të këtyre shpenzimeve nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK).

Neni 2 - Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha klubet pjesëmarrëse në Superligën Meshkujt të organizuar nga FBK për edicionin garues 2025/26 dhe çdo edicion pasues për të cilin Bordi i FBK-së vendos zbatimin e saj.

Neni 3 - Përcaktimi i përqindjes së buxhetit

1. Çdo klub i Superligës Meshkujt është i obliguar që të ndajë minimum 10% të buxhetit të tij vjetor për zhvillimin e gjeneratave të reja, përkatësisht për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e ekipeve zinxhirore (U10-U18).
2. Kjo përqindje duhet të pasqyrohet qartë në Planin Financiar të klubit që dorëzohet gjatë procesit të licencimit në FBK.

Neni 4 - Përdorimi i fondeve

Fondi i ndarë për gjeneratat e reja mund të shpenzohet vetëm për aktivitete të ndërlidhura me:

- (a) pagesat për trajnerët e ekipeve zinxhirore;



- (b) organizimin e stërvitjeve dhe garave të moshave;
- (c) blerjen e pajisjeve sportive;
- (d) transportin, ushqimin dhe akomodimin për pjesëmarrje në gara;
- (e) edukimin dhe zhvillimin profesional të trajnerëve;
- (f) çdo shpenzim tjetër të miratuar paraprakisht nga FBK që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e gjeneratave të reja.

Neni 5 - Raportimi dhe transparenca

1. Klubet obligohen të paraqesin raport financiar gjysmë-vjetor dhe vjetor për shpenzimet e realizuara në kuadër të këtij fondi, në formatin e përcaktuar nga FBK.
2. FBK ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar saktësinë e shpenzimeve.
3. Të gjitha raportet do të shqyrtohen nga administrata e FBK-së.

Neni 6 - Monitorimi dhe verifikimi

1. FBK përmes strukturave të saj kompetente do të realizojë vizita monitoruese në klube për të verifikuar implementimin e kësaj rregulloreje.
2. Klubet janë të obliguara të ofrojnë qasje në dokumente, kontrata, fatura dhe evidenca që vërtetojnë përmbushjen e këtij detyrimi.

Neni 7 - Moszbatimi dhe pasojat

1. Në rast të mos-ndarjes së përqindjes së përcaktuar ose mos-përmbushjes së detyrimeve të raportimit, klubi në fjalë mund të:
 - (a) marrë vërejtje zyrtare;
 - (b) licencohet me kusht për edicionin vijues;
 - (c) humbë të drejtën për të marrë pjesë në garat e FBK-së për një edicion;
 - (d) përjashtohet nga proceset mbështetëse të FBK-së.
2. Vendimet për masat merren nga Bordi i FBK-së me rekomandim të Komisionit për Licencim.



3. Kundër vendimit për masa nga paragrafi 2 i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së dhe atë brenda 72 orëve nga pranimi i vendimit për revokim përmes postës elektronike.

Neni 8 - Dispozita përfundimtare

- 1.** Kjo Rregullore miratohet nga Bordi i FBK-së dhe hyn në fuqi ditën e miratimit.
- 2.** Zbatimi i saj është obligativ për të gjitha klubet e Superligës Meshkujt.
- 3.** Për çdo çështje që nuk është e rregulluar me këtë dokument, zbatohen dispozitat e Rregullores për Licencim dhe Garim dhe aktet tjera normative të FBK-së.

E miratuar në Prishtinë më 03.08.2025.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës





ANEKS II

DOKUMENT UDHËZUES - PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN DHE TRAJNIMIN E GJENERATAVE TË REJA

Ky dokument është pjesë përbërëse e Rregullores për Licencim dhe Garim dhe e Federatës së Basketbollit të Kosovës (edicioni 2025/26) dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e saj.

Në mbështetje të Rregullores për Licencim dhe Garim - Edicioni 2025/26 dhe në kuadër të përforsimit të kriterëve për zhvillimin e gjeneratave të reja dhe të standardizimit të punës me grup-moshat e reja, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka përgatitur këtë dokument udhëzues për Programin për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja.

Ky dokument udhëzues është pjesë integrale e kriterëve të licencimit dhe, si i tillë, është detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha klubet dhe shkollat që aplikojnë për licencë në FBK.

Dokumenti ndahet në dy pjesë kryesore:

1. Programi për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja - fokusohet në aspektin afatgjatë të punës me të rinjtë dhe përfshin përcaktimin e vizionit, misionit dhe objektivave strategjike të klubit për zhvillimin e gjeneratave të reja, filozofinë e punës me grup-moshat dhe planin e përgjithshëm për ngritjen e cilësisë në periudhë shumëvjeçare.

2. Programi Vjetor i Stërvitjeve për Grupmoshat U10-U18 - ka karakter praktik dhe operacional, duke përfshirë planifikimin e detajuar të stërvitjeve gjatë vitit për secilën grupmoshë, strukturën stërvitore, objektivat teknike dhe fizike, si dhe standardizimin e metodologjisë së punës në terren.



1. PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E GJENERATAVE TË REJA

Programi për zhvillimin e gjeneratave të reja përbën një nga shtyllat strategjike të Rregullores për Licencim dhe Garim. Klubet e licencuara, veçanërisht ato që operojnë në nivelin më të lartë të garave (Superliga Meshkujt dhe Femrat), janë të detyruara të zhvillojnë struktura zinxhirore të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për grupmoshat U10 deri në U18.

Ky program përfshin:

- Funksionalizimin dhe përkrahjen e ekipeve të moshave;
- Angazhimin e trajnerëve të kualifikuar për çdo grupmoshë;
- Pjesëmarrjen e rregullt në garat zyrtare të FBK-së;
- Investime në pajisje dhe logjistikë për grupmoshat;
- Ofrimin e kushteve të përshtatshme për edukim, mirëqenie dhe mbrojtje të fëmijëve;
- Bashkëpunimin me shkollat e basketbollit dhe komunitetin lokal për rritjen e bazës së lojtarëve;
- Monitorimin dhe raportimin e progresit në baza vjetore tek FBK.

Për të garantuar që ky program të mos mbetet në nivel formal, FBK ka vendosur që klubet e Superligës Meshkujt të ndajnë të paktën 10% të buxhetit vjetor për këtë qëllim, në përputhje me Rregulloren e veçantë për Shpenzimet për Gjeneratat e Reja ([ANEKS I](#)).

Zbatimi i këtij programi është kriter kyç për licencim dhe do të kontrollohet rregullisht nga strukturat përkatëse të FBK-së.

2. PROGRAMI VJETOR I STËRVITJEVE PËR GRUPMOSHAT U10-U18

REKOMANDIME PROFESIONALE

Janë përgatitur rekomandime profesionale bazuar në udhëzimet për ngarkesën e lojtarëve dhe trajnerëve në klubet e basketbollit tek gjeneratat e reja. Këto rekomandime vlejné për të gjitha klubet në procesin e licencimit



dhe në periudhën afatgjate kontribuojnë në rritjen e cilësisë së punës me grup-moshat e reja.

Qëllimi i këtyre rekomandimeve është që të përshtaten në mënyrë adekuate ngarkesat fizike dhe profesionale të sportistëve dhe stafit teknik, duke siguruar punë cilësore brenda kornizës së përcaktuar:

- Për sportistët, në kalendar janë të përcaktuara periudha të caktuara si dhe ngarkesat javore maksimale dhe minimale të rekomanduara sipas grup-moshave;
- Për stafin profesional, janë të përcaktuara ngarkesat javore të përafërta dhe detyrat që lidhen me punën e tyre, si dhe standardet minimale të nevojshme.

KALENDARI I PUNËS PËR GRUPMOSHAT E REJA

Kategoria	Periudha përgatitore (Fillimi i stërvitjeve)		Periudha garuese		Periudha kalimtare		Pushimi
	Më herët	Më vonë	Fillimi	Fundi	Fillimi	Fundi	
U10	Gusht	Shtator	Tetor	Maj	/	/	Nga ndeshja e fundit deri në fillim të stërvitjeve, të gjitha festat dhe pushimet



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

U12	Gusht	Shtator	Tetor	Maj			Pushime gjatë vitit (të paktën 50%), minimumi 1 javë pas përfundimit të sezonit dhe nga java e 2-të e qershorit deri në fillim të stërvitjeve
U14	Gusht	Shtator	Tetor	Maj			1 javë në dhjetor pas xhiros së fundit, të paktën 1 javë pas përfundimit të sezonit dhe nga java e 2-të e qershorit deri në fillim të stërvitjeve
U16	Gusht	Shtator	Tetor	Maj			Minimumi 4 ditë të lidhura në dhjetor pas xhiros së fundit, të paktën 1 javë pas përfundimit të sezonit dhe nga java e 3-të e qershorit deri në fillim të stërvitjeve



U18	Gusht	Shtator	Tetor	Maj			Minimumi 4 ditë të lidhura në dhjetor pas xhiros së fundit, të paktën 1 javë pas përfundimit të sezonit dhe nga java e 3-të e qershorit deri në fillim të stërvitjeve
------------	-------	---------	-------	-----	--	--	---

NGARKESAT JAVORE TË GRUPMOSHAVE TË REJA

Kategoria	Periudha Përgatitore		Periudha Garuese		Periudha Kalimtare	
	Min.	Maks.	Min.	Maks.	Min.	Maks.
U10	2x60 min stërvitje	2x90 min	2x60 min stërvitje + 2x40 min ndeshje	2x90 min stërvitje + 2x40 min ndeshje	2x60 min stërvitje	2x90 min
U12	3x90 min stërvitje	4x90 min stërvitje + 1x30 min aktivitete tjera	3x60 min stërvitje + 2x40 min ndeshje	4x90 min stërvitje + 1x45 min individuale + 1x30 min aktivitete + 1x90 min ndeshje	3x60 min stërvitje	4x90 min + 1x45 min individuale + 1x30 min aktivitete



U14	4x90 min stërvitje + 1x30 min aktivitete	5x90 min stërvitje + 2x45 min individuale + 2x30 min aktivitete	4x90 min stërvitje + 1x30 min aktivitete + 1x90 min ndeshje	5x90 min stërvitje + 2x45 min individuale + 2x30 min aktivitete + 2x90 min ndeshje	4x90 min + 1x30 min aktivitete	5x90 min + 2x45 min individuale + 2x30 min aktivitete
U16	5x90 min + 1x45 min individuale + 1x30 min aktivitete	5x120 min + 3x60 min individuale + 2x30 min aktivitete	5x90 min + 1x45 min individuale + 1x30 min aktivitete + 1x90 min ndeshje	5x120 min + 3x60 min individuale + 2x30 min aktivitete + 2x90 min ndeshje	5x90 min + 1x45 min individuale + 1x30 min aktivitete	5x120 min + 3x60 min individuale + 2x30 min aktivitete
U18	5x90 min + 2x45 min individuale + 1x30 min aktivitete	5x120 min + 3x90 min individuale + 2x30 min aktivitete	5x90 min + 2x45 min individuale + 1x30 min aktivitete + 1x90 min ndeshje	5x120 min + 3x90 min individuale + 2x30 min aktivitete + 2x90 min ndeshje	5x90 min + 2x45 min individuale + 1x30 min aktivitete	5x120 min + 3x90 min individuale + 2x30 min aktivitete

Shpjegime:

- Ndeshjet përgatitore llogariten si pjesë e stërvitjeve. Gjatë kësaj periudhe, për U12, U14, U16, U18 janë të dedikuara dy javë për përgatitje intensive, ku vëllimi i punës mund të rritet deri në 2x në ditë.
- Në periudhën kalimtare, ekipi fokusohet në përmirësimin e teknikës basketbollistike dhe përgatitjes fizike.



Rekomandime:

- Sportisti duhet të ketë të paktën 1 ditë të lirë në javë edhe gjatë periudhës garuese;
- Orari i stërvitjeve të jetë më së voni deri në ora 20:00 për fëmijët deri në moshën 14 vjeçare dhe deri në 22:00 për grup-moshat 14-17 vjeç;
- Numri i fëmijëve të angazhuar në një stërvitje mos të kaloj numrin e 20 vijuesve deri në moshën 14 vjeçare, dhe jo më shumë se 16 fëmijë në grup nga mosha 14-18 vjeçare;
- Të sigurohet numri i stërvitjeve sipas grup-moshave:
 - (a) Mosha U10: 2 stërvitje në javë
 - (b) Mosha U12: 2-3 stërvitje në javë
 - (c) Mosha U14: 3-4 stërvitje në javë
 - (d) Mosha U16: 4-5 stërvitje në javë
 - (e) Mosha U18: 5-6 stërvitje në javë

*Në qoftë se është e mundur numri i këtyre stërvitjeve mund edhe të tejkalohet me ata fëmijë të cilët kanë mundësi të stërvitin edhe 2x në ditë, qoftë me stërvitje individuale, grupore, ekipore, etj.

KËRKESAT E DORËZIMIT NGA KLUBET PËR LICENCIM

Klubet duhet të dorëzojnë një **program vjetor për secilën grupmoshë** (U10-U18) që përfshin:

- Kalendar i sezonal (4 periudha të ndara);
- Numri i stërvitjeve dhe përmbajtja orientuese javore;
- Periudhat e pushimit;
- Trajneri përgjegjës për secilën grupmoshë;
- Objektivat e zhvillimit (teknik, fizik, social).

FBK do të përdorë këtë program për monitorim dhe vlerësim të përmbushjes së kriterëve.

TRAJNIM DHE MBËSHTETJE NGA FBK

FBK do të ofrojë:

- Trajnime për trajnerët e moshave;
- Mbështetje teknike për hartimin dhe vlerësimin e programit.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

E miratuar në Prishtinë më 03.08.2025.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës





ANEKS III

RREGULLORE PËR MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E SHKOLLAVE TË BASKETBOLLIT

Neni 1 - Qëllimi

1. Duke u mbështetur në nenin 24 të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sport, dhe në përputhje me Statutin e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), kjo Rregullore është miratuar si pjesë përbërëse e Rregullores për Licencim dhe Garim dhe e Federatës së Basketbollit të Kosovës (edicioni 2025/26) dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e saj dhe me aktet tjera normative të FBK-së.
2. Kjo rregullore përcakton procedurat, kriteret dhe mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të shkollave të basketbollit të licencuara pranë FBK-së, duke siguruar standarde të përshtatshme edukative, teknike, infrastrukturore dhe etike.

Neni 2 - Detyrimet ndaj FBK-së

3. Shkollat e licencuara janë të obliguara:
 - (a) Të respektojnë të gjitha aktet normative të FBK-së;
 - (b) Të raportojnë një herë në vit mbi ecurinë e punës sipas formatit të përcaktuar nga FBK/SHTBK;
 - (c) Të bashkëpunojnë me organet e FBK-së për aktivitetet dhe inspektimet e planifikuara;
 - (d) Të zbatojnë me përpikëri Politikën Mbrotjtëse të FBK-së dhe çdo udhëzim shtesë në raport me mbrojtjen;
 - (e) Të mos keqpërdorin emrin e FBK-së për qëllime financiare apo propagandistike.



Neni 3 - Monitorimi dhe vlerësimi

1. FBK, përmes zyrës ekzekutive dhe Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK), do të monitorojë dhe vlerësojë rregullisht shkollat e licencuara.

2. Monitorimi nënkupton procesin e mbikëqyrjes së rregullt të aktivitetit të shkollave dhe do zhvillohet sipas procedurave në vijim:

(a) Llojet e monitorimit:

- i.** Monitorim i rregullt, i planifikuar sipas programit të Federatës;
- ii.** Monitorim i jashtëzakonshëm, i kryer në rast të shkeljeve të dyshuara, raportimeve apo kërkesave nga organet kompetente.

(b) Organi kompetent:

- i.** Mbikëqyrja zhvillohet nga zyra ekzekutive e FBK-së dhe SHTBK.

(c) Procedura e monitorimit:

- i.** Monitorimi përfshin: inspektim në terren, analizë të dokumentacionit administrativ dhe financiar, intervista me trajnerë, lojtarë dhe sipas nevojës me prindër (gjithmonë duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e fëmijëve);
- ii.** Pas përfundimit, hartohet raport me gjetjet dhe rekomandimet.

3. Vlerësimi nënkupton procesin e matjes së performancës sipas indikatorëve të përcaktuar dhe do të përfshijë kontroll të dokumentacionit, kushteve teknike dhe respektimit të standardeve të trajnimit:

(a) Qëllimi i vlerësimit:

- i.** Vlerësimi kryhet të paktën një herë në vit për secilën shkollë dhe ka për qëllim përcaktimin e nivelit të pajtueshmërisë me standardet dhe progresin sportiv të shkollës.

(b) Organi kompetent:

- i.** Raporti fillestar përgatitet nga zyra ekzekutive dhe SHTBK, apo grup punues i krijuar për këtë qëllim.

(c) Indikatorët kryesorë të vlerësimit:

- i.** Administrativë: licencimi, regjistrimi i rregullt i lojtarëve, raportimi financiar.



- ii. Sportivë: numri i lojtarëve, pjesëmarrja në gara, progresi bazuar në zbatimin e Programit për Zhvillim dhe Trajnim të Gjeneratave të Reja të shkollës.
- iii. Infrastrukturë: gjendja e palestrave, siguria, pajisjet sportive.
- iv. Edukativë dhe etikë: politikat për mbrojtje, trajnimet e ndjekura, respektimi i kodeve të sjelljes.

(d) Metodologjia:

- i. Indikatorët vlerësohen nga organi kompetent dhe raporti fillestar, i cili përshin rezultatet, analizën dhe rekomandimet për përmirësim, i përcillet Bordit të FBK-së.
- ii. Në rast të identifikimit të mangësive serioze, shkollës i caktohet një periudhë korigjimi ose zbatohen sanksione sipas Nenit 5 të kësaj Rregullore dhe rregulloreve tjera përkatëse të Federatës.

Neni 4 - Mbrojta në Basketboll

1. Me theks të veçantë, ushtrimi i aktivitetit të shkollave të basketbollit kushtëzohet me zbatimin e Politikave të Mbrojtjes të FBK-së dhe çdo udhëzim shtesë të Federatës.
2. Gjatë inspektimeve vjetore dhe të jashtëzakonshme, Federata verifikon:
 - (a) Nëse politika është integruar në rregullat e brendshme të shkollës;
 - (b) Nëse ka person përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve të emëruar dhe të trajnuar;
 - (c) Nëse janë kryer kontrollet penale për trajnerët dhe stafin;
 - (d) Nëse ka sistem raportimi të brendshëm për rastet e dyshuara ose të paktën të gjithë janë të informuar për kanalet e raportimit të FBK-së.
3. Nëse Federata pranon një raportim ose ankesë që përfshin një shkollë basketbolli dhe që lidhet me:
 - (a) Shkelje të Politikës së Mbrojtjes;
 - (b) Abuzim fizik, psikologjik apo seksual ndaj të miturve;
 - (c) Sjellje të papërshtatshme të trajnerëve apo stafit;
 - (d) Rrezik për sigurinë e fëmijëve në aktivitetet sportive;



atëherë Federata është e detyruar të nisë menjëherë një monitorim të jashtëzakonshëm dhe, nëse është e nevojshme, të raportojë dhe bashkëpunojë me autoritetet kompetente shtetërore.

4. Gjatë monitorimit të jashtëzakonshëm, Federata ka të drejtë:

- (a)** Të kërkojë qasje në dokumentacionin e shkollës;
- (b)** Të zhvillojë intervista me trajnerët, prindërit dhe lojtarët;
- (c)** Të pezullojë përkohësisht licencën ose aktivitetin e trajnerëve të përfshirë deri në përfundim të hetimit;
- (d)** Të pezullojë përkohësisht licencën ose aktivitetin e shkollës së përfshirë deri në përfundim të hetimit.

5. Në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda, licenca e shkollës pezullohet menjëherë dhe çështja procedohet sipas rregulloreve përkatëse të FBK-së.

6. Ky proces është i detyrueshëm dhe ka përparësi ndaj çdo monitorimi të planifikuar.

Neni 5 - Sanksionet

1. Varësisht prej nivelit të mospërputhjes së konstatuar gjatë monitorimit apo vlerësimit, Bordi i FBK-së, pas raportit të pranuar, mund të vendos këto masa:

- (a)** Vërejtje me shkrim dhe plan korrigjimi;
- (b)** Monitorim shtesë për periudhë 3-6 mujore;
- (c)** Pezullim i përkohshëm i licencës;
- (d)** Revokim i licencës.

2. Shkeljet administrative që nuk ndikojnë sigurinë apo zhvillimin e fëmijëve do shoqërohen me vërejtje dhe plan korrigjimi apo me monitorim shtesë për periudhë të caktuar.

3. Shkeljet e rënda si: shkelje të Politikës së Mbrojtjes së FBK-së; refuzim i inspektimeve ose fshehje e informacionit; abuzim financiar ose keqadministrim i rëndë, do rezultojnë në pezullim ose revokim të menjëhershëm të licencës dhe inicim të procedurës disiplinore në përputhje me aktet normative të FBK-së.



4. Shkolla ka të drejtë ankese brenda 10 ditëve pune pas pranimit të masës dhe atë drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së.
5. Masa e pezullimit të licencës zbatohet menjëherë dhe nuk ndikohet nga ankesa, përveç në rastet kur Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit vendos ndryshe.
6. Vendimet për pezullim apo revokim të licencës bëhen publike në faqen zyrtare të FBK-së, duke respektuar të dhënat personale të fëmijëve dhe personave tjerë të përfshirë.

Neni 6 - Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.
2. FBK do të publikojë udhëzime të mëtejshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje në faqen zyrtare dhe përmes komunikimeve zyrtare me shkollat.

E miratuar në Prishtinë më 03.08.2025.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës

